



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Mbledhje e përbashkët

***Këshilli për Legjislacionin dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën
Publike dhe të Drejtat e Njeriut***

PROCESVERBAL

Tiranë, më 26.09.2018, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procedurës dhe kalendarit të shqyrtimit të projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr.9417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

-Prezantimi i nismës nga nismëtarët;

-Caktimi i relatorëve;

-Caktimi i mënyrës së njohjes së projektligjit nga zgjedhësit;

-Thirrja e ekspertëve konstitucionalistë;

2. Miratimi i kalendarit të seancave dëgjimore.

Marrin pjesë:

Gramoz Ruçi, Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Ermonela Felaj, Bledi Çuçi, Spartak Braho, Elena Xhina, Xhemal Qefalia, Edmond Leka, Alket Hyseni, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Arben Pëllumbi, Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Fatmir Mediu, Silva Caka, Edmond Haxhinasto.

Mungojnë:

Jurgis Çyrbja, Astrit Veliaj, Nasip Naço, Tom Doshi

Të ftuar:

Lefterije Luzi – Drejtore e Shërbimit të Komisioneve

Moza Arbri – Këshilltare Juriste

Moza Pano – Drejtore e Shërbimit të Seancave Plenare

Iva Seseri – Këshilltare juridike

Isida Koka – Këshilltare juridike

HAPET MBLEDHJA

Gramoz Ruçi - Të nderuar deputetë,

Fillojmë mbledhjen e përbashkët të Komisionit të Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe Këshillit të Legjislacionit. Bazuar në nenin 77/a të Rregullores së Kuvendit kam kërkuar thirrjen kësaj mbledhjeje me këtë rend dite:

- Miratimi i procedurës dhe i kalendarit të shqyrtimit të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.

- Prezantimi i nismës nga nismëtarët.
- Caktimi i relatorëve.
- Caktimi i mënyrës së njohjes së projektligjit nga zgjedhësit.
- Miratimi i ekspertëve konstitucionalistë.

(caktimi i ekspertëve)

Miratimi i kalendarit të seancave dëgjimore.

Sikurse e kam njoftuar edhe në seancën plenare të datës 13 shtator 2018, është depozituar në Kuvend projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Republikës”, e ndryshuar”, nismë e një grupi prej 44 deputetësh të opozitës parlamentare.

Projektligji është botuar menjëherë në faqen zyrtare të Kuvendit dhe u është shpërndarë njëherësh të gjithë deputetëve.

Ky projektligj bazohet në nenin 77/a, pika 1 e Rregullores, dhe është futur automatikisht në programin e punimeve të Kuvendit.

Bazuar në pikën 2 të nenit 77 të Rregullores, jo më parë se dy javë nga data e depozitimit, sot fillojmë procedurën për shqyrtimin e tij.

Sipas pikës 3 të nenit 77 të Rregullores, parashikohen për diskutim çështjet, që unë i kam përfshirë në rendin e ditës.

Për këtë arsye ju keni përpara projektligjin, relacionin shoqërues, shkresën përcjellëse, si dhe një draft-kalendar për diskutim, për shqyrtim apo për plotësimin me emra të relatorëve, të ekspertëve konstitucionalistë, me mënyrën e njohjes së projektligjit nga zgjedhësit, datat e zhvillimit të seancave dëgjimore, të shqyrtimit në parim apo për shqyrtimin nën për nen dhe në tërësi, deri te data e shqyrtimit dhe raportit të paraqitur në seancë plenare.

Fillojmë pa humbur kohë me problemin e parë që kemi në rendin e ditës, prezantimi i nismës nga nismëtarët.

Kush e do fjalën?

Urdhëroni!

Enkelejd Alibeaj – Përveç materialeve, të cilat sipas Rregullores janë të detyrueshme për t'iu shpërndarë të gjithë deputetëve, ju kemi shpërndarë në tavolinat e kësaj mbledhjeje edhe një projekt-kalendar të punimeve të mbledhjes së përbashkët të Komisionit të Ligjeve dhe Këshillit të Legjislacionit, ku shihet qartë se dita e fundit, kur duhet të mbarojë kjo procedurë, është data 30 nëntor 2018.

Së pari, dua t'ju tërheq vëmendjen se çështja e vendosjes së datave, afateve, rrugës që duhet të ndjekë amendamenti kushtetues i paraqitur nga ana jonë parapërcaktohet, sipas Rregullores, duke u bazuar në arsyetim fare të thjeshtë: sa më shpejt. Këtu bëj të ditur edhe faktin tjetër që vetëm pas presionit që bëri opozita, ju personalisht e shfaqët atë në faqen e Kuvendit edhe pse kishit detyrimin që, qysh në momentin kur ajo u depozitua, do të duhej të shfaqej në faqen *web* të Kuvendit të Republikës.

E dyta, kam përshtypjen se kjo zgjatje, stërzgjatje, që ju e keni parashikuar si projekt-kalendar, nuk është gjë tjetër veçse fakti se qysh në këtë moment keni filluar të vini në zbatim planin tuaj për ta futur në kalendar greke këtë amendament kushtetues, ndërkohë që Rregullorja, neni 77, pika 1, përcakton fare thjesht dy gjëra se çfarë mund të bëjë ky komision, që ka detyrim nga Rregullorja: caktimi i relatorëve dhe caktimi i ekspertëve.

Duke qenë se është një çështje gjerësisht e njohur, thellësisht e debatuar, publikisht e njohur edhe nga publiku shqiptar, afati që duhet vendosur për ta mbyllur procedurën në këtë parlament, të mos jetë më tepër se një javë nga fillimi i kësaj mbledhjeje.

Ky do të ishte shërbimi më i mirë, më serioz në respekt të Rregullores, në respekt të Kushtetutës, në respekt edhe të nevojës për ta miratuar një orë e më parë këtë amendament kushtetues, pra, po e konsideroj se mund të jetë një akt rutinë nga ana juaj dhe të mos ketë mbrapa një strategji për ta futur, siç e thashë edhe më par, në kalendrat greke.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Zoti Alibeaj më vjen keq, shkuat te pika e fundit e rendit të ditës. Unë jam drejtuesi i kësaj mbledhjeje. Sipas Rregullores së Kuvendit jam konsultuar me kryetarin e Komisionit të Ligjeve dhe kryetarin e Këshillit të Legjislacionit. Ky është një projekt, siç e thatë ju. Nëse ky projekt do të qëndrojë kështu siç është, është ekskluzivitet i kësaj mbledhjeje. Mund të afrohen, mund të largohen, nuk e di se çfarë kërkesash do të keni.

Ju lutem, të procedojmë me rendin e ditës, që është: prezantimi i nismës!

Pra, të fillojmë nga prezantimi i nismës dhe më pas do të shkojmë te kalendari dhe do t'i diskutojmë këto gjëra, prandaj mos u bëni pengesë për këtë çështje.

Për sa i përket asaj që thatë, meqenëse e ngritët ju, unë e votova, nuk është aspak e vërtetë, është zbatuar pikë për pikë në germë Rregullorja e Kuvendit dhe Kushtetuta. Kam parasysh, se ju kam ndjekur, ndërkohë që unë njoftova Kuvendin ishte shpërndarë në tavolinën e deputetëve, ishte botuar në faqen e Kuvendit, për fat të keq takimin ju e filluat atë ditë çerek ore me vonesë. Unë pasi e kisha mbaruar këtë punë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem! Jo, nuk është kështu!

Kryetari i Kuvendit, sipas Rregullores, njofton seancën, ua shpërndan deputetëve në seancën e parë dhe e boton menjëherë në faqen e Kuvendit.

Prandaj, ju lutem, mos nxirrni sebepe për këtë çështje!

Le të fillojmë sipas rendit të ditës, sipas Kushtetutës, sipas Rregullores me prezantimin e nismës.

Cilin keni autorizuar që të prezantojë nismën në emër të nismëtarëve?

Enkelejd Alibeaj - Zoti Bylykbashi do të bëjë prezantimin e nismës.

Gramoz Ruçi – Urdhëroni!

Oerd Bylykbashi – Kolegë prezentë në këtë mbledhje, zoti Kryetar,

Ju keni përpara këtë propozim për amendamente kushtetuese në lidhje me vetingun e politikanëve, në lidhje me marrëdhëniet e tyre, lidhjet e tyre me krimin. Ky është një

amendament që propozohet pikërisht për të bërë shkëputjen e plotë dhe përfundimtare të politikës dhe të institucioneve nga krimi, amendamente që synojnë mbrojtjen e institucioneve demokratike, duke filluar nga parlamenti, nga qeveria dhe organe të tjera të përcaktuara në këtë propozim nga penetrimi i krimit në këto institucione, penetrim, i cili vjen për shkak se politikanë të lidhur me krimin i kanë hapur derën influencës kriminale në këto institucione.

Qëllimi i këtij propozimi thuhet qartë në nenin e propozuar prej nesh: “Kontrolli i figurës ngrihet me qëllim mbrojtjen dhe garantimin e mirëfunksionimit demokratik të Kuvendit, organet e qeverisjes vendore, institucionet kushtetuese apo të krijuara me ligj nga ndikimi apo pjesëmarrja në politikëbërje dhe/ose vendimmarrje i funksionarëve që kanë kontakte me persona të përfshirë me krimin e organizuar”. Pra, synimi është mbrojtja e institucioneve nga infiltrimi i interesave kriminale për shkak të derës që u hapin politikanët e lidhur me krimin. Tashmë është e denoncuar një listë politikanësh, duke filluar nga nivel ministrash për shkak të lidhjes së tyre me familjarët e tyre, qoftë kushërinj si Tahiri, apo vëllezër si Xhafaj, përfaqësues të këtij parlamenti, të kësaj maxhorance që deklarojnë miqësi familjare me kriminelë të dënuar për trafik droge. Këta trafikantë marrin tenderë publikë në zonat elektorale ku janë zgjedhur këta, është rasti Balla dhe raste të tjera të denoncuar një për një nga opozita dhe nga media për lidhje të politikanëve me krimin.

Edi Rama Kryeministër në vitin 2013 u hapi derën kriminelëve të dënuar që të bëheshin pjesë e këtij institucioni dhe të institucioneve të tjera dhe pasi ligji për dekriminalizimin e pengoi ta bënte këtë më tutje, duke larguar 333 zyrtarë, duke përfshirë 6 deputetë të larguar ka ndryshuar mekanizmin, ka sjellë në parlament politikanë që janë të lidhur me krimin, janë përfaqësues të drejtpërdrejtë të grupeve dhe të rrjeteve kriminale apo janë përfaqësues të familjeve kriminale me lidhje gjaku. Është pikërisht ky ndryshim i qëllimshëm i marrëdhënies politikë-krim që Edi Rama ka bërë, që e bën të nevojshme që ne të shkojmë më thellë drejt vetingut të politikanëve që kanë këto lidhje me krimin.

Propozimi ynë është fare i thjeshtë: veting me të njëjtin formulim ligjor si për prokurorët, gjykatësit, policët edhe për politikanët e zgjedhur apo të emëruar në funksionet e larta kushtetuese, deputetë, ministra, kryetarë bashkish dhe drejtues të institucioneve kushtetuese. Trajtim special për politikanët nuk mund të ketë. Në këtë shtet duhet të mësojmë se politikanët nuk kanë asnjë privilegj në trajtim karshi kujtdo tjetër. I njëjti mekanizëm pastrimi të krimit dhe vetingu si për policin e thjeshtë, ashtu edhe për ministrin e Brendshëm dhe çdo zyrtar të barasvlershëm me të, i njëjti mekanizëm që përdoret për të larguar gjyqtarët dhe prokurorët e lidhur me krimin, i njëjti mekanizëm të përdoret edhe për

të larguar deputetin, ministrin, kryetarin e bashkisë, që mund të jenë të lidhur me krimin, të provuar me të njëjtat mekanizma.

Deputeti, ministri, janë e njëjta kategori kushtetuese, si gjyqtari dhe prokurori i lidhur me krimin. Pastrohet drejtësia, pastrohet politika në të njëjtën formë, pastrohet Policia e Shtetit. Nuk mund të qëndrojë ministri i paverifikuar, po për lidhjet e tij kriminale duhet të largohet. Nuk mund të largohet një polic i thjeshtë, ndërsa ministri i tij të qëndrojë, pavarësisht lidhjeve që ka me krimin.

Bëjmë sot një propozim për ndryshim të Kushtetutës, sepse është e nevojshme për të ndërhyrë e për të përcaktuar këtë parim barazie tashmë, të politikanëve me të gjithë të tjerët, për sa i përket integritetit të figurës së tyre. Nuk mundet që ne të kërkojmë integritet për policin e thjeshtë, e të pranojmë që ministri apo deputeti të mos verifikohet.

Sapo të biem dakord për këtë ndryshim të rëndësishëm, sigurisht që ne do të vazhdojmë më tutje, me të njëjtën metodikë që kemi përdorur për reformën në drejtësi: ndryshuam Kushtetutën dhe më pas shkruam ligjet, por sigurisht me cilësi më të lartë procesi, për të garantuar që ky veting i politikanëve të jetë i plotë, i thellë e të mos lërë ekuivoke, që më pas të mos merremi sërish me të njëjtin problem.

Ajo që propozojmë ne, është që të jetë proces krejtësisht i pavarur, i palidhur dhe i pandikuar nga procesi i vetingut në drejtësi, pra të palidhur me njëri-tjetrin. Ecin me të njëjtat parime, por pa interferuar absolutisht te njëri-tjetri.

Do të jetë model shumë më i thjeshtë, më i qartë, më efikas, si ai që u përdor për dekriminalizimin.

Sot janë më shumë se treqind zyrtarë të lartë shteti e më poshtë, të cilët janë larguar nga ai model i thjeshtë i dekriminalizimin, pra i pastrimit të lidhjeve të krimit me institucionet shtetërore.

Do të kryhet nga një strukturë profesionale, krejtësisht e pavarur nga politika. Politika, parlamenti, nuk mund të bëjnë vetingun. Ne mund të vendosim, për shkak se populli, njerëzit, kërkojnë shkëputjen e lidhjeve të politikës me krimin. Është detyra jonë t'u përgjigjemi, duke vendosur sot kriteret në Kushtetutë, e më pas në ligj, mekanizmat e qarta dhe efikase, që mund ta bëjnë këtë. Por kjo nuk mund të jetë detyrë e politikës, sepse politikanët, deputetët, ministrat, do të jenë subjekti i këtij verifikimi, e më pas i masave larguese nga institucionet, i masave penguese për të marrë sërish funksione në drejtimin e shtetit.

Pra, në konceptin tonë, ajo që ne propozojmë është që ky proces të ketë edhe mbikëqyrje ndërkombëtare, për të garantuar çuarjen e procesit deri në fund, me transparencë

në interes të opinionit publik, dhe që askush të mos e pengojë pengon atë për të gjetur shmangiet.

Përcaktimin ose definicionin e vetingut, të lidhjes së politikanëve me krimin, sot e kemi në Kushtetutë. E kemi edhe në ligjin e vetingut. Është i njëjti koncept që përdoret për gjyqtarët dhe prokurorët. Me të njëjtin definicion largojmë edhe deputetët e lidhur me krimin, ministrat e lidhur me krimin, kryetarët e bashkive të lidhur me krimin.

Procedura se si do ta identifikojmë këtë lidhje, do të jetë me të njëjtën procedurë që kemi sot në Kushtetutë dhe në ligjin e vetingut, për të larguar gjyqtarët dhe prokurorët e lidhur me krimin. Me të njëjtën procedurë i largojmë edhe këta zyrtarë të barasvlershëm kushtetues, siç janë deputetët dhe ministrat. Deputetët dhe ministrat nuk mund të jenë të mbrojtur nga interesi publik, që të mos ketë lidhje të krimit me institucionet.

Modeli do të jetë i ngjashëm me modelin e thjeshtë dhe funksional, të provuar tashmë, të ligjit të dekriminalizimit, institucione të cilat konkurrojnë me një qëllim publik, për të larguar politikanët e lidhur me krimin, njësoj siç largoi dhe vazhdon të largojë politikanët që kanë në CV-në e tyre damkën e dënimit për krim.

Për sa i përket modelit të zgjedhur, është shumë e thjeshtë: është marrë dhe ju propozohet që përpara, i njëjti tekst, me përshtatjen e vetme për sa i përket subjekteve. Me këtë propozojmë që në Kushtetutë, në procesin e vetingut, të shtohet edhe kategoria e deputetëve, ministrave, kryetarëve të bashkive dhe zyrtarëve të tjerë të lartë kushtetues, gjë që pastron dhe garanton integritetin moral për interes të publikut.

Sot është tekst ekzistues në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, miratuar me 140 vota nga Parlamenti i Shqipërisë më 22 korrik 2016. Do të jetë i njëjti mekanizëm, i njëjti koncept, i njëjti tekst, tekst i cili ka marrë jo vetëm votat e deputetëve të Republikës së Shqipërisë, por edhe bekimin e Komisionit të Venecias, në parim, në mekanizëm e në procedurë.

E përsëris, e gjithë kjo nevojë vjen nga një element shumë i thjeshtë: Edi Rama vendosi të ndryshonte mekanizmin me të cilin i dha mundësi krimit për të qenë në institucione. Nga deputetë me rekorde kriminale të drejtpërdrejta, në ministra që kanë lidhje dhe i hapin portën kriminelëve në institucionet publike. Qëllimi i dekriminalizimit dhe i vetingut të lidhjeve kriminale është mbrojtja e institucioneve demokratike nga influenza dhe penetrimi i krimit.

Të nderuar kolegë, ju i keni përpara amendamentet tona, të cilat keni pasur kohë dhe mundësi t'i shikoni, verifikoni dhe krahasoni me dispozitat ekzistuese kushtetuese. Ne, jo vetëm propozojmë që marrëdhëniet e politikanëve me krimin të verifikohen, por këtyre

zyrtarëve t'u ndërpritet mandati dhe të ndalohen që të zgjidhen apo emërohen në këto funksione në të ardhmen. I njëjti koncept siç është te ligji i dekriminalizimit.

Vetingu është një proces administrativ me një bazë kushtetuese (ne këtë propozojmë), i cili shkëput pa humbur kohë marrëdhëniet e politikës me krimin, në mënyrë që shqiptarët të rrisin besimin tek institucionet publike.

Për të mos u zgjatur, ky është qëllimi dhe mekanizmi që ne propozojmë. Miratimi i këtyre amendamenteve kushtetuese do t'i hapë rrugën vettingut të politikanëve me të njëjtën mënyrë që sot po përpiqemi të pastrojmë drejtësinë dhe policinë. Në këtë mënyrë ne krijojmë një barazi të plotë dhe nuk lëmë të privilegjuar deputetët, ministrat apo këdo politikan tjetër të zgjedhur nga organet kushtetuese, sepse është pikërisht kjo që e ka bërë në perceptimin e opinionit publik ta shohë politikën si burimin e së keqes për sa i përket koluzionit të politikës me krimin.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Bylykbashi!

Kalojmë te pika tjetër.

Kush do të shprehet për relatorët?

Enkelejd Alibeaj – Që në fillim të mbledhjes ju thashë se që nga projektkalendari që keni bërë demaskohet fakti i qëndrimit që keni mbajtur gjatë periudhës që strategjia është prezantuar në publik, por edhe në shumë hapësira të tjera, qoftë edhe mediatike, për ta shtyrë në kalendat greke duke u fshehur pas procedurës. Nuk ka ngelur i madh e i vogël, i majtë apo i djathtë, shqiptar që jeton këtu apo ata në emigrim, njerëz të cilët përjetojnë sot terrorin e krimit shtetëror dhe atij të rrugës, që nuk e ka kuptuar çfarë amendamenti kushtetues ofrojmë ne.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për procedurë e kam. Do ta kuptosh.

Ajo çfarë ne duhet të diskutojmë para se të kalojmë te çështja e relatorëve, që është rutinë, apo edhe e ekspertëve, akoma edhe më rutinë, është që tani duhet të vendosim që ky amendament kushtetues të kalojë një orë e më parë. Çështja që përcakton ...

Gramoz Ruçi – Zoti Alibeaj, si do të kalojë?

Enkelejd Alibeaj – Zoti Kryetar, më dëgjo se do të ta them.

Gramoz Ruçi – Nuk kam si të dëgjoj.

Enkelejd Alibeaj – Do të më dëgjosh, sepse ...

Gramoz Ruçi – Do të zbatohet Kushtetuta.

Enkelejd Alibeaj – Do të zbatohet Kushtetuta dhe Rregullorja.

Gramoz Ruçi – Që të vijmë te pika që thoni ju duhen caktuar relatorët, ekspertët, të mbledhemi ne për t'i pyetur, t'u lëmë kohë atyre për t'u përgjigjur ...

Enkelejd Alibeaj – Jo, jo.

Gramoz Ruçi – Dakord, do të shkojmë te kalendari.

Enkelejd Alibeaj – Rimë te kalendari njëherë pastaj te pjesa tjetër.

Gramoz Ruçi – Jo, jo, kalendari është në fund.

Enkelejd Alibeaj – Do të respektojmë Rregulloren?

Gramoz Ruçi – Pikë për pikë.

Enkelejd Alibeaj – Po jua lexoj, sepse e kam përpara.

Gramoz Ruçi – Kush janë relatorët? Ke propozim?

Enkelejd Alibeaj – Po, kam, por propozimi ka edhe një parashtresë para.

Gramoz Ruçi – Bëje propozimin për relatorin, pra.

Enkelejd Alibeaj – Kam propozim, por jo për relatorët, sepse relator kemi caktuar Oerd Bylykbashin, kurse ekspert Gazmend Bardhin. Ajo çfarë është e rëndësishme, që publiku duhet ta kuptojë dhe që është detyrim yni dhe i këtij parlamenti, për aq sa mund të quhet parlament, për një çështje kaq të rëndësishme, është që ne tashmë do të duhet të përcaktojmë që një orë e më parë këtë fazë ...

Gramoz Ruçi – Do të vijmë tek ajo pikë.

Enkelejd Alibeaj – Më lejo ta mbaroj! Pse ke siklet?

Oerd Bylykbashi – Mos e zgjat kot.

Gramoz Ruçi - Po e zgjasni ju.

Enkelejd Alibeaj – Zoti Ruçi, më dëgjo!

Gramoz Ruçi – Do të vijmë te kalendari.

Enkelejd Alibeaj – Unë e kuptoj ...

Gramoz Ruçi – Bëj propozimet konkrete.

Enkelejd Alibeaj – Propozimi ka parashtresë dhe logjikë.

Gramoz Ruçi – Nuk ka logjikë, sepse është kundër Rregullores.

Enkelejd Alibeaj – Unë e kuptoj që ai ju ka mbledhur para mbledhjes dhe ju ka thënë të bëni çfarë është e mundur për ta shtyrë në kalendat greke dhe të vendosni shkopinj në rrota, por rrotën e kësaj Rregullore dhe këtij amendamenti unë po jua shpjegoj.

Një nga çështjet e rëndësishme, që përcakton ritmin me të cilin duhet të ecë ky parlament, po ta them tani. Cilat janë arsytet pse kërkohet shpejtësia ...?

Gramoz Ruçi – Do të shkojmë atje.

Enkelejd Alibeaj – Këtu jemi, sepse unë t'i thashë propozimet.

Gramoz Ruçi – Të dëgjojmë krahun tjetër kë ka relator.

Urdhëroni! Kë keni relator?

Enkelejd Alibeaj – A ta mbaroj? Fillove ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gramoz Ruçi – Jo, të lutem!

Do të vish atje dhe do të të jap fjalën të flasësh për kalendarin!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Cilin keni relator?

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Kryetar!

Në fakt, ne jemi deputetë të Kuvendit të Shqipërisë dhe, sigurisht, kemi të drejtën e votës edhe për të vendosur për rishikimin e Kushtetutës, por në asnjë lloj rrethane dhe në asnjë lloj mënyre nuk kemi monopolin për të shkelur Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit kur bëhet fjalë për një nismë kushtetuese, që kërkon rishikimin e Kushtetutës, si ligjin themeltar të shtetit.

Ne kërkojmë respektimin strikt të nenit 77/a të Rregullores dhe, sipas këtij rendi dite, siç është përcaktuar në pikën 3 të nenit 77/a, ne propozojmë që relatore në këtë projekt kushtetues të jetë kolegja Vasilika Hysi.

(Deputeti Alibeaj flet pa mikrofon.)

Jo, kur të vijë radha për ekspertët.

Gramoz Ruçi – Faleminderit!

(Deputeti Alibeaj flet pa mikrofon.)

Jo, do të vazhdoj unë!

Enkelejd Alibeaj – Jo, një minutë, për procedurë!

Gramoz Ruçi – Vazhdojmë me caktimin e ekspertëve dhe të konstitucionalistëve.

Enkelejd Alibeaj – Të lutem!

Gramoz Ruçi – Ju e propozuat? Kë keni?

Enkelejd Alibeaj – Po, Gazmend Bardhin, ekspert konstitucionalist.

Gramoz Ruçi – Gazmend Bardhi.

Pozita?

Ulsi Manja – Në fakt, zoti Kryetar, ne kemi dy ekspertë për të propozuar: zotin Artur Metani dhe Gledion Llatja.

Gramoz Ruçi – Ju lutem, edhe një herë emrat!

Ulsi Manja – Artur Metani dhe Gledion Llatja!

Gramoz Ruçi – Dakord, u caktuan edhe ekspertët konstitucionalistë.

Vazhdojmë me kalendarin e punimeve të mbledhjes.

Tani, urdhëroni, çfarë rezervash keni për të!

(Deputeti Manja ndërhyrje pa mikrofon)

Enkelejd Alibeaj – Edhe një të tretë, po.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gramoz Ruçi – Jo, mor, të vazhdojë.

Ulsi Manja – Kam një sugjerim për tek ekspertët konstitucionalistë.

Kur bëhet fjalë për ekspertët konstitucionalistë, ne, si deputetë të shumicës, e konsiderojmë shumë të rëndësishme marrjen e ekspertizës vendase, qoftë edhe mendimin e botës akademike dhe universitare, por është shumë e rëndësishme edhe marrja e një opinionimi miqësor nga Komisioni i Venecias. Kjo edhe si një traditë tashmë e konsoliduar e Kuvendit të Shqipërisë me këtë organizëm të rëndësishëm, sa herë që kemi pasur projekte për ndryshime kushtetuese, dhe këtu kam parasysh ndryshimet kushtetuese të vitit 2015 në kuadrin e procesit të dekriminalizimit, por edhe mendimin e Komisionit të Venecias në ndryshimet kushtetuese të vitit 2016, në kuadrin e reformës në drejtësi.

Arsyeja e dytë ka të bëjë me faktin se ky projekt kushtetues, i paraqitur sot nga opozita, interferon me kuadrin kushtetues dhe ligjor që ne kemi sot në fuqi për dekriminalizimin, por edhe me paketën e ligjeve të reformës në drejtësi, këtu e kam fjalën për ligjin “Për organet e specializuara të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar”, përkatësisht për SPAK-un dhe BKH-në, të cilin e kemi votuar bashkërisht me opozitën.

Në këtë këndvështrim, ne kërkojmë që, përveç ekspertizës vendase (ekspertizës së konstitucionalistëve shqiptarë), t’i kërkohej një opinion i specializuar edhe Komisionit të Venecias.

Gramoz Ruçi – Urdhëroni, lidhur me kalendarin!

Enkelejd Alibeaj – E nxorët fytyrën, apo jo?! Sepse jo më kot e thashë në fillim, që te projektkalendari fillon sot dhe e ke çuar deri për Krishtlindje e matanë Krishtlindjes, se thjesht e vetëm do ta shtysh në kalendat greke, me zor e gjeti zotëria kohën për të thënë: “kërkojmë ekspertë nga Komisioni i Venecias”.

Pse doni t’i fshiheni gjësë? Pse doni ta shtyni? Pse keni frikë nga vetingu i politikanëve? Pse keni frikë...

(Debat në sallë)

...nga barazia e ligjit edhe për deputetët?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gramoz Ruçi – Nuk është dakord...

Enkelejd Alibeaj – A do të vendosni rregull, zoti Ruçi, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, të lutem unë ty!

Në çfarë pike jemi ne? Ne jemi në pikën e parashikuar nga neni 77/a i Rregullores, i cili trajton mënyrën se si trajtohen amendamentet kushtetuese për atë; vendosin shpejtësinë me të cilën do të duhet të ecim. Dakord? Ndërsa pika 3 e thotë fare qartë: do ta vendosim ne mënyrën e diskutimit dhe të njohjes së këtij amendamenti me publikun. Kjo e përcakton shpejtësinë me të cilën do të duhet të ecim.

Çfarë do t'i bëjmë ne të ditur publikut? Përmbajtjen, standardin, që kemi prezantuar edhe këtu, është normale, organin dhe, mbi të gjitha, arsyet pse ne (opozita) kemi depozituar këtë amendament kushtetues. Të katër këto elemente, sot që flasim, jo vetëm janë të ditura për publikun, por publiku është duke i përjetuar në kurrizin e tij.

Standardi i vetingut të politikanëve nuk është gjë tjetër, as më shumë, as më pak, por standardi i vetingut të gjyqtarëve dhe prokurorëve; është standardi i vetingut të policëve dhe të gardistëve. Katër vjet e debatuar; katër vjet e rrahëm si çështje vetingun e gjyqtarëve dhe të prokurorëve! Katër vjet angazhuam ekspertizë nga të gjitha anët! Katër vjet angazhuam shoqërinë civile, publikun, madje 95% të shqiptarëve e donin vetingun e gjyqtarëve dhe të prokurorëve. Është diskutuar në 3D çështja e këtij standardi. Shqiptarët, publiku shqiptar jo vetëm i njeh, jo vetëm e kupton, por e ndjen atë që është duke ndodhur, që e dëshironte shumë kohë më përpara.

Çfarë ka për të njohur publiku? Çfarë ka këtu për të kërkuar një ekspertizë artificiale të Komisionit të Venecias? Kam këtu dokumentet dhe dy opinionet e dhëna nga Komisioni i Venecias, opinionin e ndërmjetëm dhe opinionin përfundimtar. Pjesa thelbësore që kanë diskutuar, ka qenë pikërisht çështja e vetingut, arsyeja pse duhet bërë, standardi si duhet bërë, modalitetet, ruajtja e procesit të rregullt ligjor dhe çdo gjë tjetër.

Ne nuk bëjmë gjë tjetër, veçse ato opinione të sintetizuara në tekstin kushtetues të aneksit të Kushtetutës, i marrim pa asnjë lloj ndryshimi dhe ua vendosim mbi kurriz politikanëve. Këtu është ezauruar doktrina në të gjitha dimensionet. Edhe nevoja është ezauruar në të gjitha dimensionet. Çështja e vetme është, nëse do ta bëjmë apo jo. A ka kurajë civile gjithsecili prej nesh këtu, që ta bëjë, apo jo? A ka kurajë morale gjithsecili prej nesh këtu për ta pranuar? A ka kurajë politike secili prej nesh këtu për ta pranuar vetingun tonë, si dhe atë për gjyqtarët, për prokurorët, për policët dhe për gardistët? Kjo është çështja. Kjo do të thotë se elementi doktrinal ka mbaruar këtu kohë më parë, sepse shqiptarët nuk e njohin thjesht dhe vetëm vetingun si të shkruar në Kushtetutë. Ata e njohin vetëm si veting të

shkruar në ligj. Sot po shohin edhe rezultatin. Jo vetëm kaq, por keni qenë ju këtu e një vit më parë, që bërtitët me forcë se vetingun për gjyqtarët dhe për prokurorët do ta bënit edhe për policët, edhe për gardistët.

Ju e përjashtuat Fatmir Xhafajn në atë kohë edhe pse jua kërkuam, por i keni vënë për veting gjyqtarët, policët dhe gardistët. Ju nuk kishit nevojë atëherë për ta çuar në Komisionin e Venecias dhe për të kërkuar ekspertizë. Pse nuk i qëndroni të njëjtit qëndrim, si atëherë?

Ndryshimi i vetëm është vetëm një: para një viti ata, të cilët do ta mbanin në kurriz ish-in policët dhe gardistët, ndërsa sot, do të duhet ta mbajmë ne. Shqiptarët e duan këtë punë, si për policët, si për gardistët, si për gjyqtarët dhe për prokurorët. Shumë mirë, të bëhet vetingu, por mbi të gjitha, të bëhet për politikanët.

Çështja tjetër është ajo, që duhet t'i bëjmë të ditur publikut. Ne jemi fare të qartë: do ta bëjnë profesionistët me mbikëqyrje ndërkombëtare, por jo nga politika, se nuk ka sens dhe është tallje. Të bëhet një veting i besueshëm dhe profesional me një model si vetingu i gjyqtarëve. U gjet mekanizmi dhe modeli për vetingun e gjyqtarëve dhe të prokurorëve. Po ashtu, u gjet një model edhe për vetingun e policëve dhe të gardistëve.

E gjetëm edhe modelin për politikanët. Ja ku e keni. Mbi të gjitha, ajo që është e rëndësishme, që realisht këtë duhet t'ia bënim të ditur publikut (ç' thotë Rregullorja) motivet që na frymëzuan për ta sjellë këtë amendament kushtetues, pra arsyeja pse ne kërkojmë të ndryshojmë Kushtetutën.

Çfarë ka këtu të panjohur nga shqiptarët? Ka të panjohur faktin, që sot ministri i Brendshëm ka të vëllanë të dënuar, sepse është marrë me krim të organizuar, apo që sot ka një ministër të Brendshëm me një shofer të vetëvrarë me dy plumba dhe me një orë mbi 17 mijë euro?!

Ka të panjohur faktin, që sot kryetari i Grupit Parlamentar të PS-së ka deklaruar pa iu tutur qepalla, se është i lidhur me një anëtar të një bande të rrezikshme, të cilin e ka ndihmuar edhe për të përfituar...

Gramoz Ruçi – Ju lutem, zoti Alibeaj!

Mos më detyroni t'ju pres fjalën!

Enkelejd Alibeaj – Jo, nuk ma pret dot fjalën!

Gramoz Ruçi – Të lutem, mos lanço emrat e askujt këtu!

Enkelejd Alibeaj – Një minutë!

Gramoz Ruçi – Të lutem!

Enkelejd Alibeaj – Cili është problemi?

Gramoz Ruçi – Problemi është të përcaktojmë axhendën për të trajtuar nismën kushtetuese.

Enkelejd Alibeaj – Te axhenda jemi.

Gramoz Ruçi – Urdhëro për axhendën!

Enkelejd Alibeaj – Axhenda që duan shqiptarët, që na e kërkon Rregullorja është: çfarë motivi na çoi ne këtu? Është thjesht një dell poetik i opozitës apo është nevojë ulëritëse e shqiptarëve? Kjo është nevojë ulëritëse e shqiptarëve pikërisht për këto raste. Pse ju vjen keq juve? Kur Taulant Balla tha se e ka mik, nuk pyeti asnjë prej jush. Dakord?

Kur Jurgis Çyrbja fliste në telefon me anëtarët e bandës së Shullazit, nuk ju ka pyetur juve, apo jo?

Kur Fatmir Xhafaj mbronte të vëllanë për të bërë para me krim dhe me lojërat e fatit, nuk ju ka pyetur juve, apo jo? Ai e mbajti 8 muaj ligjin, apo jo?

Gramoz Ruçi – Zoti Alibeaj, nëse keni ndonjë gjë për kalendarin.

Enkelejd Alibeaj – Çfarë kalendari? Po unë për kalendarin po flas.

Gramoz Ruçi – Çfarë kalendari?

Enkelejd Alibeaj – Një minutë! Po unë për kalendarin po flas.

Këto janë motivet...

Gramoz Ruçi – Urdhëro, bëj propozime!

Enkelejd Alibeaj – Të lutem!

Këto janë motivet...

Gramoz Ruçi – Do të shkojmë më pas te diskutimi në parim dhe më pas nën për nen, ku do t'i thoni të gjitha këto.

Enkelejd Alibeaj – Jemi te çështja, te pika 3 e Rregullores. Neni 77/a kërkon jo vetëm prezantimin, por edhe ritmin me të cilin duhet ta kalojmë këtë nismë, apo jo? E vetmja gjë që përcakton ritmin, nevojën dhe urgjencën, përveç caktimit të ekspertëve vendas dhe të relatorëve, që i caktuam, është fakti që duhet t'ia bëjmë publikut. Po, është detyrimi ynë. Këtë po ju them. Publiku shqiptar e ka të qartë sot se si tentakulat e krimit janë futur fort edhe në eshtrën e këtij parlamenti, me emra konkretë. Kjo është arsyeja. Këta emra konkretë duhet t'ia bëjmë të ditur publikut, për të kuptuar që nuk ka nevojë të bësh një kalendar dhe ta çosh deri në nëntor, deri për Krishtlindje apo për Vitin e Ri, sepse nuk është gjë tjetër veçse strategji për ta çuar në kalendat greke, sepse nuk ka nevojë ta thërrasësh në mënyrë miqësore Komisionin e Venecias. E ka thënë, e ka shkruar, 3 herë madje!

Nuk ka nevojë për ta diskutuar për publikun, kur amendamenti që ne kemi parashikuar këtu ka vetëm 3 dispozita, të cilat i kemi në Kushtetutën shqiptare sot dhe e

vetmja gjë ku bëjmë ndryshim është të vendosim termin “politikan” në vend të “gjyqtar” dhe “prokuror”, ne, ju, qeveria, parlamenti, drejtuesit më të lartë të këtij shteti, ata të cilët kanë fatin e qeverisjes së çdo shqiptari.

Duhet të kuptoni një gjë: me këtë amendament kushtetues, të gjithë ne, qeveria, drejtuesit më të lartë shtetërorë, jemi në konflikt interesi. Për këtë arsye, duhet të jemi shumë të kujdesshëm, që të mos emetojmë asnjë lloj sinjali për t’i rënë ndesh nevojës së publikut dhe vullnetit të tij, të cilin e ka shprehur me gjyqtarët, me prokurorët, me policët, me gardistët.

Të parët dhe të vetmit që duhet t’i ishin nënshtruar këtij filtri duhet të ishin politikanët, jo vetëm për moral. Sidomos tani kur ka fakte dhe raste konkrete se si drejtues të lartë të shtetit, ata që qeverisin shqiptarët, sot janë me prova, jo me dyshime, e zezë mbi të bardhë, të pranura vetë të lidhur me krimin.

Nevoja është ulëritëse dhe emergjencë.

Gramoz Ruçi – Çfarë po propozoni?

Enkelejd Alibeaj – Propozimi im është... E thashë në fillim, por ju nuk e keni mendjen, sepse jua thashë, ju kanë mbledhur më përpara dhe ju kanë thënë ta shtyni këtë mbledhje.

Gramoz Ruçi – Më thuaj propozimin dhe lëre se kush na ka mbledhur ne, të lutem shumë!

Enkelejd Alibeaj – Propozimi është: caktuam ekspertët, caktuam relatorët dhe pas një jave ta mbyllim këtë procedurë dhe ta miratojmë një orë e më parë. Koha nuk pret!

Gramoz Ruçi – Në rregull.

Enkelejd Alibeaj – Nuk ka asgjë për të diskutuar. Nuk ka asgjë për të pasur mendime alternative. Nevoja është ekstreme, zgjidhja është proporcionale. Zgjidhja është debatuar në Komisionin e Venecias. Zgjidhja është sot efektive, po aplikohet për gjyqtarët dhe prokurorët. Për barazi dhe për të mos krijuar privilegj për politikanët ka thjesht dhe vetëm një akt që mund të bëjmë: pro.

Gramoz Ruçi - E kam të qartë propozimin. Ta dëgjojmë edhe mendimin alternativ për propozimin tuaj?

Urdhëroni, zoti Manja.

Ulsi Manja – Zoti Kryetar, të nderuar kolegë, çështja e rishikimit të Kushtetutës nuk është çështje e aktrimit politik, as imja dhe e askujt.

E thashë që në fillim, bëhet fjalë për rishikimin e ligjit themeltar të shtetit, Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Sot ne kemi të drejtën e votës, kemi të drejtën e

fjalës, por nuk kemi absolutisht tagrin për të shkelur Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë, aq më tepër kur Shqipëria sot ka një kuadër të plotë kushtetues dhe ligjor, lidhur me procesin e dekriminalizimit të politikës, por edhe në kuadrin e reformës në drejtësi.

Tani, unë nuk e kuptoj (singerisht e them) këtë merakun e madh të opozitës për të mos e çuar këtë projekt kushtetues në Venecia, për të marrë një opinion më të kualifikuar, por e konsideroj si qëndrim me dy standarde të opozitës.

Fatmirësisht, kjo sallë dhe këta mure kanë edhe memorie parlamentare. Kam dy procesverbale këtu, të datës 26.03.2015 dhe 15.04.2015 të Komisionit të Posaçëm parlamentar për Dekriminalizimin, të cilin e ka kryesuar kolegu im i opozitës Oerd Bylykbashi (gjenden lehtësisht të aksesueshëm për opinionin publik, por edhe për mediat në faqen e Kuvendit), që thoshte: “Nuk ka sens që një projekt kushtetues të mos shkojë në Venecia.” Sot, kur kemi një kuadër të plotë kushtetues dhe ligjor për pastrimin e politikës nga radhët e politikanëve dhe zyrtarëve merr rekorde kriminale, opozita bërtet këtu për nevojën ulëritëse dhe urgjente për të shkelur Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit.

Zoti Kryetar, ne kërkojmë në trajtimin e kësaj nisme, nga ky Këshill i Legjislacionit dhe Komisioni i Ligjeve, as më shumë e as më pak se respektimin e nenit 77/a të Rregullores. Klauam në pikën 3, në caktimin e relatorëve. Natyrisht, faza tjetër, siç e përcakton Rregullorja, është përcaktimi i një kalendari për të zhvilluar seancat dëgjimore dhe për të thithur mendimin e ekspertëve vendas, por edhe të opinionit të Komisionit të Venecias, sepse të mos harrojmë që po kërkojmë të ndërhyjmë për të disatën herë në Kushtetutë, që nuk mund të jetë kurrësi statuti i partive tona politike, as i Partisë Socialiste, as i Partisë Demokratike, por është ligji themeltar i shtetit.

Unë dhe kolegët e mi të maxhorancës nuk kemi asnjë nevojë urgjente për ta shkelur Kushtetutën e vendit. Po, patjetër, nisma është në procedurë parlamentare. E thashë, nuk është aktrim politik, por është procedurë, është Kushtetutë dhe Rregullore. Këtë kërkojmë ne sot dhe më duket se këtu jemi shumë transparent me kolegët, me mediet, por edhe me opinionin publik. Kush dëshiron të shkelë Kushtetutën e vendit, është i lirë ta bëjë, por ne nuk e kemi këtë tagër.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Nuk ka propozim, ai shprehu dakordësinë për draftkalendarin...

Ulsi Manja – Dhe dërgimin e draftit në Venecia.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gramoz Ruçi – Mund të flasësh për argumentet që ke.

Enkelejd Alibeaj – Ne jemi në konflikt interesi për këtë arsye dhe detyrimi i vetëm që kemi është t’u flasim shqiptarëve me argumente dhe me logjikë.

Çfarë tha kolegu? Meqë kolegu Bylykbashi paska thënë dikur, po e marr të mirëqenë, që ligji i dekriminalizimit duhet të shkonte në Venecia dhe shkoi, ju nuk thatë gjë tjetër veçse përforcuat atë që unë thashë. Në Venecia nuk paska shkuar vetëm dy herë për gjyqtarët dhe prokurorët, por ka shkuar edhe për ligjin e dekriminalizimit. Vetingu tre herë ka bërë vajtje-ardhje, me gondola, Tiranë – Venecia dhe ne e kemi miratuar. Pse paska nevojë për një herë të katërt? Ky është argumenti që sapo thatë dhe bëtë mirë që e thatë, sepse përforcuat faktin që etapa Venecia është ezauruar me kohë e me vakt. Ajo që në mënyrë të pamoralshme po emetoni tani, është që doni ta shtyni dhe ta shtyni. Unë e kam të qartë që nuk mendoni me mendjen tuaj, sepse ai që ju ka mbledhur përpara kësaj mbledhje, ju ka dhënë këtë detyrë: bëni çfarë është e mundur, edhe pa sedër profesionale dhe pa kujtesë të praktikës parlamentare, të nxirrni arsye thjesht dhe vetëm për ta shtyrë, sepse ai ka frikë.

Meqenëse ju drejtove Rregullores, ajo është fare e thjeshtë dhe përmban tri gjëra. Nga momenti që depozitohet amendamenti, i cili duhet të ishte shfaqur që ditën e parë për t’u konsultuar me publikun, në këtë mbledhje bëhen vetëm tri gjëra: Një, caktohen relatorët dhe i caktuam.

Dy, caktohen ekspertët dhe i caktuam, një ne dhe dy ju.

E treta, përcaktohet nevoja e shpejtësisë për ta kaluar dhe diskutuar. Kjo shpejtësi kërkon kohë dhe hapësirë kur është një nismë e re e panjohur më parë, e pa rrahur në aspektin doktrinar dhe në aspektin e njohjes së publikut.

Publiku shqiptar i njeh shumë mirë bëmat, arsyet dhe motivet, që na çuan këtu. Sapo t’i listova kolegët e tu, përfaqësues të lartë të politikës të lidhur me krimin dhe zgjidhja e vetme racionale është të bëhet veting politikanësh, siç është për gjyqtarët, për prokurorët dhe për policët.

Shqiptarët e kanë të qartë dhe e njohin mirë çështjen “Venecia”, jo dy herë siç thashë unë, por tre herë, siç e tha edhe zoti Manja, e ka trajtuar çështjen dhe ka thënë: “Po, vlen, duhet dhe është zgjidhje efektive”. Kjo do të thotë se nuk ka nevojë ta tjerim më shumë sesa kaq, thjesht dhe vetëm një javë kohë mbas kësaj mbledhjeje ne e mbyllim këtë procedurë dhe e votojmë. Mos e dëgjoni atë që ju thotë: “Mos e votoni”. Këtë ua kemi detyrim shqiptarëve, sistemit, publikut, të sotmes dhe mbi të gjitha të ardhmes, sa të mos jetë vonë.

Të kuptoni edhe diçka të fundit, nuk është thjesht dhe vetëm një amendament kushtetues që përmban vetingun, por përcakton shumë gjëra për të ardhmen e këtij vendi, jo vetëm në rrafshin politik, më kuptoni mirë në këtë që po them, por edhe në rrafshin publik,

sepse mbas këtij momenti, kur ne politikanët e ruajmë fort korracën, për të mos qenë si pjesa tjetër e publikut që ne nuk e marrim në rrefene, ai publik ka shumë të drejtë për të gjithë politikanët të mos i marrë në rrefene dhe të mos i përfill. Ai e ka drejtën, ai ka moralin, ai ka legjitimitetin më pas të bëjë veting të fortë në politikë, prandaj ju thashë që është detyrim moral, politik, civil, madje është edhe individual. Kush voton sot për amendamentin tonë kushtetues, që, në fakt, nuk është yni, por është i Venecias, nuk bën gjë tjetër veçse fiton, asgjë më tepër dhe asgjë më pak, simpatinë e publikut. Kaq e thjeshtë është, nuk ka nevojë që ta shtyjme në kalendrat greke. E kuptoni?

Gramoz Ruçi – Urdhëroni, zoti Bylykbashi!

Oerd Bylykbashi – Duke parë shqetësimin që ngriti kolegu Manja, pyetja ime për të është cilën germë të neneve të Rregullores, që rregullojnë këtë pjesë, shkel propozimin që bëjmë ne?

Gramoz Ruçi – Nuk ka...

Oerd Bylykbashi – Nuk ka shkelje...

Gramoz Ruçi – Të lutem! Procedurën e përcakton kjo mbledhje.

Oerd Bylykbashi – Graviteti i çështjes i provuar me listë emrash përcakton dhe nevojën për të ecur shpejt, sepse është interes publik.

Tri herë ka shkuar në Venecia i kopsitur nga të gjitha krahët, quaje dekriminalizim, quaje veting të krimit nga politika, njësoj është, i ka dhënë tri herë parimit, procedurës dhe rezultatit që është largimi i krimit dhe pengimi për të hyrë përsëri. “Venecia” ka thënë se është në përputhje me standardin ndërkombëtar që institucionet demokratike të mbrohen nga penetrimi i krimit duke i penguar të hyjnë nëpërmjet zgjedhjes apo emërimit ose edhe duke i larguar nga ushtrimi i këtyre funksioneve. Ky është moment për të mbajtur qëndrim, jo për t’u fshehur pas procedurash. Procedurat e rregullores janë pikë për pikë të zbatuara, çdo shtesë, sigurisht, tregon qëllimin tuaj, por qëndrimi ynë në interes të publikut shqiptar është ky: i mbyllim derën e krimit për të hyrë në institucione, përzëmë ata që ia hapin krimit derën e institucionit nga brenda, pra politikanët që janë të lidhur me ta. Qëndrimin tuaj duhet të shprehni sot dhe pastaj do të vazhdojmë më tej.

Gramoz Ruçi- Ju faleminderit!

Ju lutem, do të procedoj unë tani. Për publikun dhe për komisionin është propozuar një draftkalendar dhe anatemohet se është shtyrje për të fshehur e të tjera muhabete.

Mendimet janë të qarta, janë të ndara, pjesa e opozitës thotë që të shpejtohet procesi dhe të bëhet brenda javës me argumentet përkatëse. Unë, si drejtues i kësaj mbledhjeje, kam përgatitur një draft që e shtroj për diskutim, i cili ka mbështetjen e maxhorancës. Për

publikun dua të jem i qartë se nga ky moment që po flasim është lënë mbledhje çdo shtatë ditë, pra janë parashikuar: një seancë për t'iu bërë pyetje ekspertëve konstitucionalistë, më falni se stafi përkatës ka neglizhuar që duhet të shtojë një mbledhje tjetër për të dëgjuar përgjigjet e konstitucionalistëve që nuk parashikuar aty, pra, do të lihet një mbledhje më vete që, pasi të marrin detyrën konstitucionalistët, do të japin mendimet e tyre për pyetjet që u shtruan; është lënë një seancë dëgjimore në kuadrin e njohjes me shoqërinë civile, siç e përcakton Kushtetuta dhe Rregullorja; një takim tjetër pas një jave me botën akademike; një takim tjetër me përfaqësues të profesioneve të lira; një takim tjetër me institucionet shtetërore dhe partnerët ndërkombëtarë; janë lënë 4 seanca dëgjimore me 4 universitete, është lënë diskutimi në parim, është lënë diskutimi nen për nen dhe pastaj përgatitja e relatorëve dhe paraqitja në seancë plenare. Ka edhe një propozim të minorancës që të mos jetë ky kalendar, por të bëhet një kalendar njëjavor.

Kush është dakord me propozimin e opozitës?

Enkelejd Alibeaj - Pse nxitoni?

Më jepni fjalën.

Gramoz Ruçi – Kush është dakord me propozimin e opozitës që të bëhet një kalendar njëjavor për të miratuar ndryshimet kushtetuese?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush është kundër? Abstenime?

Nuk miratohet.

Kush është dakord me programin e paraqitur nga Kryetari i Kuvendit? Kundër? Abstenime?

Miratohet programi.

Ka një propozim të dytë, sipas të cilit drafti t'i çohet për ekspertizë dhe për mendim Komisionit të Venecias. Kush është dakord? Kundër?

Miratohet.

Këtu mbyllet mbledhja.

Mbledhja tjetër është për të bërë pyetjet për ekspertët. Përgatituni.